



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Ali Çankaja
Pronar
RTV Yeni Donem
Prizren

Vendimi LIC-KKPM: 2009/20

Ref: 0912/2309/KKPM/ni

VENDIM

në lidhje me kërkesën për ndryshimin e emrit të Radio dhe TV stacioni Yeni Donem (RTV) në RTV Ballkan

Fakte

1. RTV Yeni Donem është subjekt transmetues i cili e ka selin dhe transmeton në Prizren. Subjekti transmetues në fjalë ka pranuar licencën e përkohshme të modifikuar nga ana e Komisionerit të Përkohshëm për Media, me datën 27 maj 2005.
2. Me vendim të Këshillit të KPM-së dhe me kërkesë të ish pronarit z. Mehmet Butuc, pronësia e RTV Yeni Donem është ndryshuar më 18 shkurt 2009 duke u bartur në tërësi në emër të z. Ali Çankaja.
3. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), më datën 22 dhjetor 2009 ka pranuar kërkesën nga pronari i RTV Yeni Donem për ndryshimin e emrit të radio dhe TV stacionit në "RTV Ballkan".

Arsyetim

4. RTV Yeni Donem ka bërë kërkesën për ndryshimin e emrit në "RTV Ballkan". Në vendimin për lejimin e ndryshimit të emrit, KPM duhet të marrë parasyshë, që emri i propozuar të mos jetë i ngjajshëm me emrin e subjekteve tjera transmetues e sidomos në rajonin ku transmeton ky subjekt transmetues, i cili do t'u a bënte të vështirë qytetarve identifikimin mes subjekteve transmetuese. Poashtu, KPM me këtë rastë merrë parasysh që emri i propozuar për ndryshim, të mos ketë elemente të cilat në mënyrë të tërthortë apo të drejtëpërdrejtë të jenë potencialisht ç'orientuese apo ofenduese për publikun.
5. Prandaj, KPM duke u bazuar në interesin e përgjithshëm nuk ka ndonjë arsye që mos të lejojë RTV Yeni Donem ta ndyshojë emrin, dhe me këtë rastë KPM gjenë se emri i

në territorin e Prizrenit apo edhe në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe në këtë mënyrë nuk do të jetë potencialisht shqetsues për publikun. Emri i propozuar "RTV Ballkan" nuk do të ketë ndikim ç'orientues apo fyes për publikun, prandaj në këtë mënyrë Këshilli i KPM-së pajtohet që të bëhet ndryshimi i emrit të RTV Yeni Donem në "RTV Ballkan".

Vendim

6. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media në bazë të kërkesës së RTV Yeni Donem merr vendim për ndryshimin e emrit të këtyre subjekteve transemtuese (radio dhe TV) në RTV Ballkan.

Lëshimi i Vendimit

7. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.


Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.



30.12.2009
datë

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në harmoni me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës si dhe në pajtueshmëri të plotë me rregullat e procedurës së KPM-së.


Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive

30.12.2009
datë